

-  
=



**Republika e Kosovës – Republika Kosova**  
*Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa*  
*Izborni Panel za Žalbe i Predstavke*

**A nr. 1212/2013**

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Muharrem Shala kryesues, Xhevdet Abazi dhe Hasan Shala anëtarë, duke vendosur përkitazi me ankesat e Avni Krasniqit – Kandidatë për Anëtarë të Kuvendit Komunal (PDK) në Prishtinë, paraqitur kundër Komisionit Qendror Zgjedhor (KQZ), për shkak të manipulimit me vota, të zgjedhjeve lokale, në seancën e panelit të mbajtur me 06.12.2013, mori këtë:

### **V E N D I M**

**Refuzohen si të pabazuara ankesat:** Anr.1212, Anr.1213, 1214, të datës 03.12.2013, të Avni Krasniqit – Kandidatë për Anëtarë të Kuvendit Komunal (PDK) në Prishtinë .

### **Arsyetim**

PZAP-i, ka pranuar ankesat: Anr.1212, Anr.1213, 1214 të datës 03.12.2013, të Avni Krasniqit – Kandidatë për Anëtarë të Kuvendit Komunal në Prishtinë, në të cilat ankesa pretendohet se ka pasur keqpërdorime dhe manipulime të votave.

- Në ankesën Anr.1212/13 të datës 03.12.2013, pretendohet se në QV1926E kanë votuar kandidatin për Asamble Komunale nga PDK-ja nr.53. Parashtruesi i ankesës e ka bashkangjitur një deklaratë nga Gëzim Cakolli ku ka theksuar se, në QV1926E e kemi votuar familjarisht kandidatin e PDK-së dhe qëndroi prapa kësaj deklarate.
- Në ankesën Anr.1213/13 të datës 03.12.2013, pretendohet se në QV 1904E/002R kanë votuar kandidatin për asamble komunale me nr.53, ku më është keqpërdorur vota ime dhe e familjarëve të mi. Parashtruesi i ankesës e ka bashkangjitur një deklaratë nga Bylend Berisha ku ka theksuar se në QV1904E/002R e kanë votuar kandidatin e PDK- së për asamble komunale dhe qëndroi pranë kësaj deklarate.
- Në ankesën Anr.1214/13 të datës 03.12.2013 , pretendohet se, në QV1919E/06D konsideroi që vota ime dhe e familjarëve është keqpërdorur nga individ të caktuar. Parashtruesi i ankesës e ka bashkangjitur një deklaratë nga Avni Krasniqi ku ka theksuar se në QV1919E/06D konsideroi s vota ime dhe e familjarëve të mi është keqpërdorur.

Bazuar në nenin 6.3 të “Rregullave dhe Procedurave” të PZAP-it, në të cilin parashihet se: “Me qëllim të lehtësimit të shqyrtimit të ankesave, Kryesuesi i Panelit mund të vendos ta bëjë bashkimin e ankesave që përmbajnë në vete çështje të ngjashme, paneli vendim-marrës i trajton ato ankesa sikurse të ishin një ankesë”. Në rastin konkret Kryesuesi i Panelit duke u bazuar në dispozitën ligjore të lartcekur ka vendosur ti bashkoi ankesat e sipërsënuara dhe ti trajtoi si një ankesë.

PZAP-i, pasi që shqyrtoi ankesat gjeti se:

### **Ankesat janë të pa bazuara**

Pretendimet ankimore nga ana e Avni Krasniqit – Kandidatë për Anëtarë të Kuvendit Komunal në Prishtinë, paraqitur kundër Komisionit Qendror Zgjedhor (KQZ), ku dyshohet për pa rregullsi dhe keqpërdorime si dhe munges të konsiderueshme të votave nëpër QV, mirëpo nuk është ofruar asnjë provë relevante nga ana e palës ankuese, me të cilat do të mund të vërtetoheshin shkeljet e supozuara.

Prandaj për shkakun se nuk janë ofruar dëshmi bindëse për të vërtetuar se kanë ndodhur dhe janë evidentuar pa rregullsi dhe keqpërdorime gjatë procesit të votimit në QV, të lartcekura nga parashtruesi i ankesës, PZAP-i konstatoi se pretendimet ankimore janë të përgjithshme dhe të pa qarta për tu vërtetuar dhe ankesat e lartpërmendura u refuzuan si të pa bazuara, prandaj duke u bazuar në nenin 118 paragrafi 1 të LZP-së, lidhur me ankesat e lartë përmendura u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

### **Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia**

A nr. 1212/2013 më datën 06.12.2013



**Këshillë juridike:** Ndaj këtij vendimi mund të paraqitni ankesë në Gjykatën Supreme të Republikës së Kosovës brenda 24 orëve nga momenti i marrjes së vendimit nga PZAP-i.